



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.131 dt.30.10.2001

**PER  
FINANCIM PROJEKTESH**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 neni 5, “Për buxhetin lokal” dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2001”, kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Njerëzore (Sektori i Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë vlerën prej 600.000 lekësh, për financimin e projekteve të paraqitura nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore:
  - “Ndhmë për fëmijët me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike”, në shumën 300.000 lekëi
  - “Shërbim në familje”, shërbime ndihmëse dhe asistencë në familje e në komunitet për personat me aftësi të kufizuar, në shumën 300.000 lekë
2. Kjo shumë të përballohet nga të ardhurat e Aparatit të Bashkisë për shpenzime operative

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Drejtoria Financës për zbatimin e këtij Vendimi
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**









